




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. D-p.	DPK
Nr. i llog. Shprehja N. i llog.	02
Nr. Prot. Prot. Nr.	03-02/4331/18
Data Data	05-12-2018
SHKËRTIME	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 03.12.2018, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2186/18, për zyrtarin e lartë z. Fazli Gajraku, Drejtor i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës dhe për znj. Liri Cami, Udhëheqëse e Divizionit të Librit dhe Bibliotekës në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë z. Fazli Gajraku, Drejtor i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës dhe për znj. Liri Cami, Udhëheqëse e Divizionit të Librit dhe Bibliotekës në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Pas informatë së marrë nga raportuesi me pretendime për konflikt interesi sipas të cilit zyrtari i lartë z. Fazli Gajraku, Drejtor i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, në cilësinë e anëtarit të Këshillit të librit i ka dhënë subvencione të librit një punonjësi të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës. Ndërsa, znj. Liri Cami, Udhëheqëse e Divizionit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe



Sportit në cilësinë e Anëtares së Këshillit të Librit, është dyshuar se i ka dhënë subvencion një personi me të cilin ka lidhje familjare (vjehtëri).

Pas kësaj, Agjencia kundër Korrupsionit i ka njoftuar zyrtarët e lartë me një shkresë zyrtare për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese janë organizuar takime me zyrtarët e lartë në Agjencinë kundër Korrupsionit. Gjatë këtij takimi zyrtari i lartë Fazli Gajraku është deklaruar se Këshilli i Librit është organ Këshillëdhënës i cili që ka për qëllim të japë iniciativa dhe të propozojë vendime në të mirë të veprimtarisë botuese, të librit dhe leximit të tij. Zyrtarja e lartë znj. Liri Cami, është deklaruar se gjatë mbledhjes së mbajtur të Këshillit të Librit lidhur me subvencionimin e projekteve ka deklaruar konflikt të mundshëm të interesit dhe nuk ka marrë pjesë në votim.

Agjencia kundër Korrupsionit pas shqyrtimit të Dokumentacionit lidhur me këtë rast, vlerëson se zyrtarët e lartë janë anëtar të Këshillit të Librit sipas detyrës zyrtare duke u bazuar në Ligjin nr.02/L-51 për Veprimtarinë Botuese dhe Librin.

E drejtë për të konkuruar për subvencionimin e librit kanë të gjithë botuesit që i plotësojnë kriteret e konkursit, dhe nuk ka ndalesa të përcaktuara.

Po ashtu, Ligji për Veprimtarinë Botuese dhe Librin, Rregullorja e punës së Këshillit të Librit, si dhe Konkursi i shpallur nuk kanë përcaktuar ndonjë ndalesë lidhur me aplikantët.

Këshilli i Librit vetëm ka propozuar përfituesit të cilët i kanë plotësuar kriteret për subvencionim, ndërsa Ministri i Kulturës vendos me Vendim për subvencionim të Librave.

Prandaj. Përfitimi i subvencionimit të librit nga punonjësi i Bibliotekës Kombëtare nuk paraqet konflikt interesi.

Gjatë mbajtjes së mbledhjes së Këshillit të Librit lidhur me rastin e znj. Liri Cami, është shfaqur konflikt i interesit “rast për rast”, kur pjesëmarrës për subvencionim të librit ka qenë edhe një kandidatë me të cilën ka lidhje familjare (vjehtëri), prandaj zyrtarja e lartë e ka deklaruar konfliktin e interesit dhe nuk ka marrë pjesë në votim. Kjo është dëshmuar edhe me shkresë zyrtare të pranuar nga Agjencia kundër Korrupsionit (03-03-4044/18).

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

